

Mundësi për aplikim të Bashkive në thirrjen për Rrjetet e Veprimit (URBACT Action Networks) 2026–2029 nën Programin URBACT IV

Misioni i Programit URBACT IV është të mbështesë qytetet/bashkitë në Evropë që të punojnë së bashku dhe të zhvillojnë zgjidhje të integruara për sfidat e përbashkëta urbane, duke krijuar rrjete, duke mësuar nga përvojat e njëri-tjetrit, duke nxjerrë mësim dhe duke identifikuar praktikatat e mira për të përmirësuar politikatat urbane.

Synimi i Thirrjes:

Synimi kryesor i thirrjes Rrjetet e Veprimit URBACT (URBACT Action Networks) është të mbështesë bashkitë për të zbatuar veprime konkrete urbane që adresojnë sfidat e identifikuara lokale, duke u bazuar në strategjitë ekzistuese lokale ose kornizat e politikave. Objektivi kryesor është forcimi i kapaciteteve të institucioneve lokale dhe të palëve të interesuara për të menaxhuar dhe zbatuar politika të zhvillimit të qëndrueshëm urban përmes zbatimit të veprimeve, të mësuarit nga kolegët dhe prodhimit të njohurive të zbatimit të transferueshme.

Fushat e veprimit të thirrjes:

Projektet mund të fokusohen në çdo sfidë urbane të lidhur me politikatat e BE-së, përfshirë:

- (i) konkurrueshmëria, dixhitalizimi, inovacioni dhe investimet;
- (ii) përfshirja sociale dhe barazia;
- (iii) siguria, mbrojtja dhe përgatitja;
- (iv) banesa dhe ndërtesa të përballueshme, të qëndrueshme, me cilësi të mirë dhe gjithëpërfshirëse;
- (v) veprimi për klimën, mjedisin dhe energjinë e pastër;
- (vi) lëvizshmëria.

Rrjetet mund të propozojnë gjithashtu tema të tjera ose më specifike që janë relevante për qytetet, për shembull shërbimet publike, rigjenerimi urban, shëndetësia, të rinjtë, kultura, demokracia, shkenca e qytetit, qëndrueshmëria, demografia, arsimit dhe trajnimi, ekonomia qarkulluese, menaxhimi i ujit, qeverisja urbane, planifikimi urban.

Temat ndër-sektoriale që duhet të konsiderohen nga të gjithë:

- Tranzicioni i gjelbër;
- Transformimi digjital;
- Barazia gjinore dhe përfshirja sociale.

Rezultatet e pritshme:

- Zbatim i veprimeve konkrete urbane në nivel lokal;
- Krijimi i Action Portfolio portofol veprimesh) për çdo bashki;
- Hartimi i një Actions Playbook në nivel rrjeti;
- Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe të aktorëve lokalë;
- Rritja e pjesëmarrjes së aktorëve lokalë përmes URBACT Local Groups;
- Zhvillimi i politikave urbane më efektive dhe të integruara;
- Testimi i zgjidhjeve në praktikë dhe nxjerrja e mësimave;
- Rritja e bashkëpunimit dhe vizibilitetit në nivel evropian.

Kush mund të aplikojë dhe çfarë konsorciumi pranohet:

Në këtë thirrje mund të aplikojnë:

- Bashkitë/qytetet nga BE 27 shtetet anëtare); Norvegjia dhe Zvicra; Vendet IPA Shqipëria, Bosnje & Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia), të cilat mund të marrin pjesë në operacione që marrin bashkëfinancim nga IPA; Ukraina dhe Moldavia.

Programi i Bashkëpunimit URBACT IV identifikon përcakton dy kategori përfituesish: Përfituesit kryesorë (Bashkisë) dhe përfituesit e tjerë (partnerët jo-Bashki).

Përfituesit kryesorë duhet të jenë të gatshme për të zbatuar veprime në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm urban.

Përfituesit e tjerë mund të jenë:

- Autoritetet provinciale, rajonale dhe kombëtare, për sa i përket çështjeve urbane;
- Universitetet dhe qendrat kërkimore, për sa i përket çështjeve urbane;
- Autoritetet Menaxhuese të Politikës së Kohezionit dhe Fondeve të Solidaritetit të BE-së.

Për të qenë të përshtatshëm, partnerët jo-qytetarë duhet të jenë autoritete publike ose Organe Publike Ekuivalente.

Partnerët Kryesorë janë aktorë kyç të partneriteteve transnacionale për Rrjetet e Veprimit. Ata kanë përgjegjësi të plotë për menaxhimin e rrjetit, koordinimin e aktiviteteve midis partnerëve transnacionalë, komunikimin në nivel rrjeti dhe BE-je, si dhe zbatimin e programit të punës. Partneri Kryesor gjithashtu mban përgjegjësi dhe detyrim financiar dhe ligjor për të gjithë partneritetin ndaj Autoritetit Menaxhues të URBACT. Bashkitë nga Shtetet Anëtare të BE-së dhe Shtetet Partnere mund të jenë Partnerë Kryesorë të Rrjeteve të Veprimit. Duke marrë parasysh përgjegjësitë e Partnerëve Kryesorë, një qytet duhet të vlerësojë me kujdes kapacitetin e tij për të marrë përsipër një rol të tillë. Ky kapacitet i Partnerit Kryesor për të përmbushur këtë rol do t'i nënshtrohet procesit të vlerësimit. Në rast se Partneri Kryesor është një bashki nga një Shtet Partner (Norvegjia, Zvicra, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Moldavia, Mali i Zi, Serbia, Ukraina), një dispozitë specifike do të përfshihet në kontratat e subvencionimit në lidhje me përgjegjësinë për fondet e BE-së të alokuara për rrjetin dhe flukset financiare midis Autoritetit Menaxhues të URBACT dhe përfituesve të programit (Partneri Kryesor dhe Partnerët).

Partneri Kryesor kandidat mund të jetë Partner Kryesor kandidat vetëm në një propozim URBACT sipas kësaj thirrjeje.

Rregullat e formimit të konsorciumi:

- Një partneritet duhet të përfshijë 6 deri në 8 partnerë;
- Partnerët duhet të jenë institucione të pranueshme nga të gjitha llojet e rajoneve të Shteteve Anëtare të BE-së, si dhe nga Norvegjia, Zvicra, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, Ukraina ose Moldavia.
- Të paktën gjysma e partnerëve duhet të vijnë nga Shtetet Anëtare të BE-së (4 në rastin e një partneriteti prej 7 subjektesh).
- Një partneritet mund të përfshijë maksimumi 1 partner nga vendet IPA dhe NDICI.
- Një partneritet nuk mund të përfshijë dy partnerë nga i njëjti Shtet Anëtar/Partner.
- Një partneritet mund të përfshijë maksimumi 1 "partner jo-bashki" (siç përcaktohet në seksionin 2.2).
- Një partner nuk mund të jetë partner në më shumë se dy Rrjete Veprimi të miratuara në të njëjtën kohë.
- Një bashki candidate mund të jetë Partner Kryesor kandidat vetëm i një propozimi të Rrjetit të Veprimit, por mund të jetë edhe Partner Projekti në një rrjet tjetër në të njëjtën kohë.

Aktivitetet e pranueshme:

Takime transnacionale dhe shkëmbim përvojash;
Organizimi i "Action Labs" në çdo qytet;
Krijimi dhe funksionimi i URBACT Local Groups;
Zbatimi i veprimeve konkrete lokale;
Studime, analiza dhe zhvillim politikash;
Trajnime dhe ngritje kapacitetesh;
Aktivitetet e komunikimit dhe shpërndarjes së rezultateve.

- Nuk ka një minimum ose limit të madhësisë së popullsisë për qytetet që dëshirojnë të marrin pjesë në aktivitetet e URBACT. URBACT mbështet autoritetet urbane nga lagjja deri në nivelin e zonës funksionale urbane në varësi të temës së trajtuar dhe ndikimit që mund të ketë. Kjo përfshin lidhjet urbane-rurale dhe zonat funksionale urbane ndërkufitare.
- Bashkitë pa përvojë të mëparshme në URBACT ftohen të aplikojnë. Mbështetje specifike do t'u ofrohet bashkive të reja.
- Veprimet e propozuara që do të zbatohen në nivel lokal duhet të bazohen në një strategji, politikë lokale ose plan veprimi ekzistues.

Paketat e Punës:

Rrjetet e Veprimit do të operojnë dhe zbatojnë aktivitetet e rrjetit të strukturuar në tre faza rreth tre paketave të punës:

Paketa e punës 1 (WP1) – Menaxhimi i rrjetit

Paketa e punës 2 (WP2) – Aktivitete në nivel rrjeti

Paketa e punës 3 (WP3) – Aktivitete në nivel lokal

Aktivitetet dhe etapat:

1. Aktivizim - Nëntor 2026 – Maj 2027 - Planifikimi, krijimi i partneritetit, studimi bazë dhe roadmap
2. Zhvillim dhe Zbatim - Qershor 2027 – Janar 2029 - Shkëmbim, zhvillim dhe implementim i veprimeve
3. Finalizim - Shkurt 2029 – Prill 2029 - Përfundimi i rezultateve dhe shpërndarja

Në çdo fazë përfshihen:

- Takime ndërkombëtare;
- Aktivitetet lokale;
- Produkte dhe raporte;
- Komunikim dhe diseminim.

Cili është buxheti i thirrjes – Buxheti dhe Bashkëfinancimi:

- Buxheti maksimal i përgjithshëm i pranueshëm për një Rrjet Veprimi do të jetë 1.000.000 euro (duke përfshirë fondet ERDF, IPA, NDICI dhe bashkëfinancimin lokal). Buxheti duhet të propozohet duke marrë parasysh numrin e partnerëve dhe veprimeve që do të zbatohen brenda projektit;
- Të paktën 50% për veprime konkrete lokale;
- Kohëzgjatja: 30 muaj.

Kategoritë buxhetore të pranueshme:

- Kostot e Stafit
- Zyra dhe Administrata
- Udhëtimi dhe Akomodimi
- Ekspertiza dhe Shërbimet e Jashtme
- Pajisjet

Normat e bashkëfinancimit:

Partnerët nga vendet IPA bashkëfinancohen deri në 95% nga Fondet IPA.

Për Shqipërinë: 5% bashkëfinancim lokal.

Buxheti për ekspertizën:

Maksimumi: 127,500 euro

750 €/ditë për ekspert;

Maksimum 170 ditë;
Lead Expert max 130 ditë);
Ad-hoc Experts min 40 ditë);
Udhëtimi i ekspertëve mbulohet nga programi.

Si bëhet aplikimi:

Aplikimi kryhet përmes platformës SYNERGIE-CTE: <https://cte-2127.synergie-europe.fr/>

Për të paraqitur një propozim rrjeti, aplikantët duhet të kryejnë hapat e mëposhtëm:

1) Të plotësojnë dhe të dorëzojnë aplikimin e tyre përmes SYNERGIE-CTE në anglisht. Do të pranohen vetëm aplikimet e paraqitura duke përdorur SYNERGIE-CTE.

2) Të dërgojnë paketën e aplikimit të përbërë nga skanimi i dokumentit PDF të nënshkruar të aplikimit të gjeneruar përmes SYNERGIE-CTE dhe të gjitha dokumentet shtesë të kërkuara (shiko më poshtë) me email në AN@urbact.eu.

Aplikantët duhet të dërgojnë me email të gjitha dokumentet e mëposhtme:

- Versionin PDF të skanuar dhe të nënshkruar të Aplikimit të paraqitur të gjeneruar përmes SYNERGIE-CTE. Duhet të jetë nënshkruar nga Koordinatorin e Projektit të Bashkisë Partner Kryesor;
- Shkresa e angazhimit në anglisht për **TË GJITHË partnerët e përfshirë në partneritet** (një shkresë për Partnerin Kryesor plus një letër për secilin Partner Projekt) duke përdorur shabllonet e dhëna në shtojcat 2 dhe 3 të guidës së thirrjes. Letrat e Angazhimit duhet të nënshkruhen nga përfaqësuesi ligjor i institucionit partner;
- CV e Koordinatorit të Projektit tek Partneri Kryesor.

Aplikantët duhet të presin një email që konfirmon marrjen e paketës së aplikimit, i cili do të dërgohet nga Sekretariati i URBACT-it dhe do të konfirmojë dërgimin me sukses.

Kur është afati i fundit:

- Aplikimi online: **17 qershor 2026, ora 15:00 CEST**
- Dokumentet me email: **18 qershor 2026, ora 15:00 CEST**

Linku i Thirrjes:

<https://urbact.eu/get-involved>